



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

RELACION

Korçë, më _____.____.2023

“PËRMIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”

Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, qëndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën qirasësore ose të qirasë reale në tregun e lirë.

Bazuar në vlerësimin e nevojave për strehim dhe mundësitë financiare për të mbështetur me fonde këtë program që aplikon Bashkia Korçë për familjet e pastreha pa të ardhura ,me të ardhura të ulëta, shumë të ulëta zbatohet në bashkëfinancim me fonde të siguruar nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave sipas përcaktimeve për kufinj të financimit sipas Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për Programet e Strehimit”, ku thuhet që, *financimi nga buxheti i shtetit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore do të bëhet në varësi të të ardhurave për frymë të NJVV*.Për bashkinë Korçë raporti në bashkëfinancim është i detyruar në kufinj të më pak se 30% e fondit të nevojshëm nga buxheti i bashkisë dhe 70% e fondit tjetër mbështetet nga buxheti i shtetit.Për vitin 2023,për programin e subvencionimit të qirasë nga buxheti i shtetit nëpërmjet MFE është miratuar dhe çelur fondi në vlerën 1,160,195 Lek.Aplikimi është i hapur dhe për tju erdhur në ndihmë familjeve në nevojë për strehim social nëpërmjet mbështetjes me bonus strehimi nuk ka asnjë kufizim në kohë,mjafton plotësimi i kriterëve dhe rregullave të bazuara në ligj.

Nga aplikimet që janë bërë në sistemin online të strehimit ,listojmë 4 familje që janë në plotësim të kriterëve të përcaktuara në nenin 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.Sipas përcaktimeve për qiranë e përballeshme të cilën familja arrin ta paguajë vetë me të ardhurat e vetë në vlerë të përfitur bonusin e strehimit në masë të plotë ose të pjesshme sipas kushteve të secilit aplikant.

Paraqesim një përshkrim të shkurtër mbi këto 4 (katër) familje si më poshtë vijon :

1-**Nertil Pëllumb Mulla**, kategoria PAK, me të ardhura shumë të ulëta,familja ka 2 antarë,data e nënshkrimit të Kontratës të Qirasë sipas aktit noterial është 16.05.2023,vlera e qirasë mujore 12.000 lekë . Subvencionimi i qirasë për vitin 2023 do të jetë i pjesshëm dhe përfitohet nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit bashkiak,sipas të dhënave në tab bashkangjitur.

2-**Fatjon Engjëll Ali**, familje pa të ardhura, komunitetit egjiptian,familje e re,me 4 antarë sipas certifikatës familjare,data e nënshkrimit të Kontratës të Qirasë sipas aktit noterial është 26.05.2023,vlera e qirasë mujore 9000 lekë. Subvencionimi i qirasë për vitin 2023 do të jetë i plotë, dhe përfitohet nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit bashkiak,

Sipas të dhënave në tab bashkangjitur. 3-**Fatbardha Hekur Hamolli**,kategoria familje njëprindërore që ka në ngarkim fëmijë, njëpjesëtar është me aftësi të kufizuara , me të ardhura shumë të ulëta. Data e nënshkrimit të Kontratës të Qirasë sipas aktit noterial 02.06.2023,vlerae qirasë mujore 12.000 lek.

Subvencionimi i qirasë për vitin 2023 do të jetë i pjesshëm dhe përfitohet nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit bashkiak,sipas të dhënave në tab bashkangjitur.

4-**Fjonika Naum Shkodrani**, kategoria familje pa të ardhura, trajtohet me ndihmë ekonomike, familja ka 5 anëtarë ,data e nënshkrimit të kontratës sipas aktit noterial 06.02.2023 me vlerë të qirasë mujore 15.000 lek. Subvencionin e qirasë për vitin 2023 do të jetë i plotë, dhe përfitohet nga momenti që lista e përfituesve miratohet me vendim të këshillit bashkiak, sipas të dhënave në tab bashkangjitur.

Në mbështetje të:

-Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social ”i ndryshuar, të neneve 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, VKM 384 , datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM 362 , datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr.459 datë 3.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave tënjësivëtvetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjetnjësivëtvetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” ,Ligjit nr.68/2017 “Për financat evetqeverisjes vendore”, VKB Nr 9 datë 25.01.2023 “Mbi miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë”, -VKB Nr.97 , datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencionin e qirasë në tregun e lirë , -VKB Nr 183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe të PBA 2023-2025 të Bashkisë Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë:

-Subvencionin e qirasë për 4 familje aplikante ,sipas tabelës bashkangjitur.

Subvencionin e qirasë do t’i jepet përfituesve nga data që lista e përfituesve miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

Drejtores Strehimit Social
Menaxhimit të Banesave Sociale.

Drejtores e Përgjithshme Juridike
dhe e Burimeve Njerëzore.
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

dhe

Mirela Balli

Drejtores e Përgjithshme të Financës ,
Buxhetit dhe MFK.
Valbona Ziko

KRYETARE E KOMISIONITË STREHIMIT
Benila Themeli

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

KËSHILLI I BASHKISË

P/VENDIM
Nr., datë .2023

“PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social ”i ndryshuar, në nenet 3, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384 datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362 , datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB Nr.97 datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencionit i qirasë në tregun e lirë, VKB Nr 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023dhe te PBA 2023-2025 të Bashkisë Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Sociale Menaxhimit të Banesave Sociale dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, Këshilli Bashkiak Korçë

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 4(katër) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’u jepet përfituesve që nga data e miratimit të listës bashkëngjitur me vendim të Këshillit Bashkiak.
3. Përzbatimin e këtijvendimigarkohetDrejtoriae Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoriae Përgjithshme eFinancës ,Buxhetidhe MFK.
4. Ky vendimhynnëfuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak**K R Y E T A R**

Eva NAÇI

Ana VERUSHIMiratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2023

“PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasimorinëshqyrtimrelacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, bazuar në dispozitat ligjore, në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384”, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB Nr.97 datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i qirasë në tregun e lirë VKB Nr 183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe të PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 4 (katër) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’u jepet përfituesve që nga data e miratimit të listës bashkëngjitur me vendim të Këshillit Bashkiak .
3. Përzbatimin e këtij vendim i garkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak **K R Y E T A R**

Eva NAÇI

Ana VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____